**4.2.3** The Chargor being under the ERE regulatory regime, after the signing of this Agreement, shall receive the prior approval of ERE by applying in writing to ERE within 3 (three) days from the signing of this Agreement, by sending a written request to ERE through registered mail (in Albanian 'Lajmërim Marrje') to comply with ERE Regulation no.235 dated 26.11.2021 "On the approval of "Regulation on the procedures and terms for the granting of authorisation from ERE, for the change of legal status of the licensee(s), change of shareholder who controls the interests of the licensee and the placement of the shares of the shareholder who controls the interests of the licensee, as means to secure the repayment of obligations to the third parties". Once the ERE approval is issued and it is notified officially to the Chargor, the latter has the obligation to provide to the Chargee, within 3 (three) days from the date of receipt of the formal approval of ERE, the notarised copies of the documents evidencing that the required procedure for approval by ERE is duly exhausted regarding this Securing Charge Agreement. Notwithstanding the above, the Parties consent herein that the procedure for the approval by ERE of this Securing Charge over the existing and any future Shares of the Chargor does not represent a legal requirement for the completion and/or perfection of the Securing Charge, but it is required to comply with the regulatory regime of ERE given that the Chargor is a licensee duly licensed by ERE.

**4.2.4** The Parties agree herein that any future Shares will be registered with the Registry of Securing Charge and that this registration will be made by the Chargee immediately and once the ownership title of these future

njoftim me shkrim në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Barrëmarrësin dhe dëshminë e regjistrimit të lëshuara nga Regjistri i Barrëve Siguruese.

**4.2.3** Barrëdhënësi, duke qenë se i nënshtrohet regjimit rregullator të ERE-s, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, duhet të marrë miratimin paraprak të ERE-s, duke aplikuar me shkrim pranë ERE-s brenda 3 (tre) ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshje, duke i dërguar ERE-s kërkesë me shkrim me postë me 'Lajmërim Marrje', në zbatim të Rregullores së ERE-s nr.235, datë 26.11.2021 "Për miratimin e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve". Pasi të jepet miratimi i ERE-s dhe t'i njoftohet zyrtarisht Barrëdhënësit, ky i fundit ka detyrimin t'i japë Barrëmarrësit brenda 3 (tre) ditësh nga data e marrjes së miratimit zyrtar të ERE-s, kopjet e noterizuara të dokumenteve që vërtetojnë se procedura e nevojshme për miratimin e ERE-s është kryer rregullisht në lidhje me këtë Marrëveshje Siguruese. Pavarësisht sa më sipër, Palët pranojnë në këtë Marrëveshje, se procedura për miratimin nga ERE të kësaj Barre Siguruese mbi Kuotat e tashme ose të ardhshme të Barrëdhënësit, nuk përbën kërkesë ligjore për kompletimin e Barrës Siguruese, por nevojitet për të respektuar regjimin rregullator të ERE-s duke qenë se Barrëdhënësi është i licencuar nga ERE.

**4.2.4** Palët bien dakord në këtë Marrëveshje që çdo Kuotë e ardhshme do të regjistrohet në Regjistrin e Barrëve Siguruese dhe regjistrimi do të bëhet nga Barrëmarrësi menjëherë dhe pasi



AC02305025010232330

Shares stands with the Chargor, following the procedure as required by the Securing Charge Law.

4.2.5 The Parties agree herein that the Shares subject to this Securing Charge, to the extent applicable to the Shares, will be subject to reappraisal subject to the followings:

(i) First reappraisal will be performed not earlier than 4 (four) years after the signing date of this Securing Charge Agreement.

(ii) The Security Agent / Chargee has the right to request in writing the reappraisal of Shares every 3 (three) years. The reappraisal will be performed only upon written request of the Security Agent / Chargee.

Notwithstanding the above paragraphs (i) and (ii) herein above in this clause 4.2.5, the Security Agent / Chargee may request a reappraisal at any time upon the occurrence of an Event of Default.

(iii) The Chargor can choose an appraiser from the list of pre-agreed entities (such list to be provided by Security Agent / Chargee) or from a different entity subject to the prior written consent of the Security Agent / Chargee. The Chargor has the obligation to cooperate with the appraiser and provide all the relevant documents and to provide access to all relevant Shares, etc.

(iv) The Chargor has the obligation to provide to the Security Agent the Share or the list of Shares, as applicable, with their relevant updated values that are subject to this Securing Charge.

## 5. OCCURRENCE OF AN ENFORCEMENT EVENT

### 5.1 Enforcement of Securing Charge

5.1.1 The Chargor consents herein without reservation that upon the occurrence of an Enforcement Event

Barrëdhënësi të ketë titullin i pronësisë mbi këto Kuota të ardhshme, duke ndjekur procedurën e kërkuar nga Ligji për Barrët Siguruese.

4.2.5 Pafet bien dakord në këtë Marrëveshje se Kuotat objekt i kësaj Marrëveshje Siguruese do të jenë objekt rivlerësimi si më poshtë, në masën e zbatueshme për Kuotat:

(i) Rivlerësimi i parë do të kryhet jo më parë se 4 (katër) vjet nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Barrë Siguruese.

(ii) Agjenti i Kolateralit / Barrëmarrësi ka të drejtë të kërkojë me shkrim rivlerësimin e Kuotave çdo 3 (tre) vjet. Rivlerësimi do të kryhet vetëm me kërkesë me shkrim nga Agjenti i Kolateralit / Barrëmarrësi.

Pavarësisht paragrafëve (i) dhe (ii) më sipër në këtë nen 4.2.5, Agjenti i Kolateralit / Barrëmarrësi mund të kërkojë kryerjen e rivlerësimit në çdo kohë në rast se ndodh një Ngjarje Mospërmbushje.

(iii) Barrëdhënësi mund të zgjedhë vlerësuesin nga lista e subjekteve të miratuara paraprakisht (listë e cila vendoset në dispozicion nga Agjenti i Kolateralit / Barrëmarrësi) ose një vlerësues tjetër i cili i nënshtrohet miratimit paraprak me shkrim të Agjenti i Kolateralit / Barrëmarrësi. Barrëdhënësi ka detyrimin të bashkëpunojë me vlerësuesin dhe të vendosë në dispozicion të gjithë dokumentacionin përkatës dhe të japë akses në të gjitha Kuotat, etj.

(iv) Barrëdhënësi ka detyrimin t'i japë Agjenti i Kolateralit / Barrëmarrësit Kuotën ose listën e Kuotave, sipas rastit, me vlerat e tyre përkatëse të përditësuara, që janë objekt i kësaj Barre Siguruese.

## 5. NDODHJA E RASTIT TË EKZEKUTIMIT TË DETYRUESHËM

### 5.1 Ekzekutimi i Barrës Siguruese

5.1.1 Barrëdhënësi pranon pa rezerva se me ndodhjen e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm dhe në



A2003050230102230330

and at any time thereafter, but in any case not before ERE having granted its approval to the creation of the security under this Securing Charge Agreement pursuant to Clause 4.2.3 (Specific Steps to be taken) herein above, the Chargee, on the basis of this Agreement or of a special Power of Attorney issued by the Chargor to the Chargee, shall have, in addition to any rights or remedies it may be entitled to under this Agreement or Albanian Law, without having the need for any further approval/consent of ERE, except that which has to be received as provided under Clause 5.1.1(e) herein below, the right to declare immediately due and payable all of the Secured Obligations, to start and finalise the enforcement of this security and collect all or part of the Secured Obligations including court costs, lawyers' fees and other legal expenses, and all rights and remedies of a Chargee under the Securing Charge Law.

The Chargor acknowledges that this Agreement constitutes a "Securing Charge Agreement" for the purposes of Article 2 of the Securing Charge Law and an "executive title" for the purposes of the Albanian Law and is subject to enforcement pursuant to the provisions of the Article 31 of the Securing Charge Law.

In particular, upon or after the occurrence of an Enforcement Event, the Chargee may, in addition to any other rights and remedies it may have by operation of law:

- (a) Retain all or any part of the Collateral in satisfaction of the Secured Obligations then due but unpaid as provided by the Securing Charge Law.

çdo moment më pas, por në çdo rast jo përpara se ERE të ketë dhënë miratimin për krijimin e mjetit të sigurimit të detyrimit sipas kësaj Marrëveshje Barre Siguruese në zbatim të nenit 4.2.3 (Hapat Specifik për t'u ndërmarrë) më sipër, Barrëmarrësi, në bazë të kësaj Marrëveshje ose të Prokurës së Posaçme të lëshuar nga Barrëdhënësi për Barrëmarrësin, ka të drejtë, krahas të drejtave ose mjeteve ligjore që mund të gëzojë sipas kësaj Marrëveshje ose në bazë të Legjislacionit Shqiptar, pa qenë nevoja të marrë miratimin/pëlqimin e ERE-s, përveç miratimit që duhet të merret në zbatim të nenit 5.1.1(e) më poshtë, të deklarojë të gjitha Detyrimet e Siguruara të prapambetura dhe të pagueshme menjëherë, të nisë dhe finalizojë ekzekutimin e detyrueshëm të kësaj Barre Siguruese, dhe të arkëtojë të gjitha ose një pjesë të Detyrimeve të Siguruara, duke përfshirë, shpenzimet gjyqësore, tarifat e avokatëve dhe shpenzimet e tjera ligjore, dhe të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore të Barrëmarrësit sipas Ligjit për Barrët Siguruese.

Barrëdhënësi njeh dhe pranon se kjo Marrëveshje konsiderohet "Marrëveshje Barre Siguruese" për qëllime të nenit 2 të Ligjit për Barrët Siguruese dhe është "titull ekzekutiv" për qëllime të Legjislacionit Shqiptar dhe është objekt ekzekutimi në zbatim të dispozitave të nenit 31 të Ligjit për Barrët Siguruese.

Në veçanti, me ndodhjen e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm ose më pas, Barrëmarrësi, krahas të drejtave dhe mjeteve ligjore që mund të gëzojë në bazë të ligjit, mundet:

- (a) Të mbajë të gjithë ose një pjesë të Kolateralit për përmbushjen e Detyrimeve të Siguruara, të maturuara por nuk janë paguar, siç parashikohet nga Ligji për Barrët Siguruese.





A202305025010233330

- (b) Seize, collect, realize, transfer, borrow money on the security of, release to third parties, or otherwise deal with the Collateral or any part thereof in such manner, upon such terms and conditions and at such time or times as permitted by Securing Charge Law; and may charge on its own behalf and pay to others reasonable sums for expenses incurred and for services rendered in connection with seizing, collecting, realizing, borrowing, on the security of selling or obtaining payment of the Collateral and may add the amount of such sums to indebtedness of the Chargor to the Chargee.
- (c) Proceed to enforce payment and exercise any of the rights and remedies of the Chargee provided for in the Securing Charge Law, as well as any and all other rights and remedies possessed by the Chargee that are not disallowed by any law of the Republic of Albania.
- (d) Upon the request of the Chargee, the Chargor shall transfer or assign the Securing Charge partially or totally to any third party in accordance with proceedings under the Securing Charge Law. The proceeds realized from this transfer shall be transferred to the Chargee, which shall maintain its privilege rights over the Collateral herein described.
- (e) Upon the request of the Chargee, the Chargor shall at any time submit the notification to and receive approval by ERE on the new purchaser of the Shares as identified by the Lenders. In addition, the Chargor unconditionally and irrevocably accepts and undertakes herein that the Chargee will be authorized and entitled:

- (b) Të sekuestrojë, arkëtojnë, realizojë, transferojë, marrë hua bazuar ne Kolateral, ta çlirojë atë te të tretë ose të kryejë veprime të tjera me Kolateralin ose pjesë të tij, sipas mënyrës, kushteve dhe afateve që lejohen nga Ligji për Barrët Siguruese; dhe mund të ngarkojë në emër të vet dhe t'u paguajë të tjerëve shuma të arsyeshme për shpenzimet e kryera dhe shërbimet e kryera në lidhje me sekuestrimin, arkëtimin, realizimin, huamarrjen, mbi mejtin e sigurimit te detyrimit te shitjes ose marrjes së pagesës së Kolateralit dhe këto shuma mund t'i shtojë me vleren e detyrimit të Barrëdhënësit ndaj Barrëmarrësit.
- (c) Të vijojë me ekzekutimin e pagesës dhe ushtrimin e të drejtave dhe mjeteve ligjore të Barrëmarrësit të parashikuara në Ligjin për Barrët Siguruese, si dhe të gjitha të drejtave dhe mjeteve të tjera ligjore që Barrëmarrësi gëzon dhe që nuk ndalohen nga ligjet e tjera të Republikës së Shqipërisë.
- (d) Me kërkesë të Barrëmarrësit, Barrëdhënësi transferon ose cedon Barrën Siguruese plotësisht ose pjesërisht te të tretë, në përputhje me procedurat e parashikuara nga Ligji për Barrët Siguruese. Të ardhurat e realizuara nga ky transferim i kalojnë Barrëmarrësit, i cili gëzon të drejtat e privilegjit mbi Kolateralin e përshkruar në këtë Marrëveshje.
- (e) Me kërkesë të Barrëmarrësit, në çdo kohë Barrëdhënësi dërgon njoftimin tek ERE dhe merr miratimin prej saj për blerësin e ri të Kuotave, të identifikuar nga Huadhënësit. Gjithashtu, Barrëdhënësi pranon dhe merr përsipër në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar përmes kësaj Marrëveshje se Barrëmarrësi është i autorizuar dhe gëzon të drejtën:



A2003050230102232350

(i) to serve such notice to ERE on behalf of the Chargor if such notice has not been delivered by the Chargor, and

(ii) to follow & exhaust all procedures / requirements for ensuring / obtaining the above stated approval from ERE.

(f) After becoming aware of the Enforcement Event, the Chargee shall apply to ERE for its approval of the potential Transferee as identified by the Lender(s) in the course of the enforcement of the Securing Charge over the Shares and, thereafter, obtain such approval from ERE within the relevant applicable deadlines applicable to ERE, unless such period is extended by law with the prior consent of the Chargee given in its sole discretion, and provide copies of documents evidencing such application and a copy of ERE approval to the Chargor. This Agreement constitutes the written authorisation or power of attorney from the Chargor to the Chargee vesting the latter with all the power to apply to ERE, obtain approval, etc., as may be required for the effective enforcement of the Securing Charge. Notwithstanding the above, if specifically required by law, the Chargor issues the written authorisation or Power of Attorney to the Chargee to authorise the Chargee to exhaust the above stated procedure with ERE in the Enforcement Event.

**5.1.2** The Chargor hereby consents herein and without reservation the enforcement of the Securing Charge as provided herein and in the relevant applicable provision of Albanian legislation and also the sale and transfer of the Collateral (or any

(i) të dërgojë këtë njoftim tek ERE në emër të Barrëdhënësit, në rast se një njoftim i tillë nuk i dërgohet ERE-s nga Barrëdhënësi, dhe

(ii) të ndjekë dhe përmbushë të gjitha procedurat / kërkesat për marrjen / sigurimin e miratimit të ERE-s të përcaktuar më sipër.

(f) Pasi të marrë dijeni për Rastin e Ekzekutimit të Detyrueshëm, Barrëmarrësi do të aplikojë pranë ERE-s për të marrë miratimin për Përfituesin e mundshëm të transferimit ku do të kryet transferimi, të identifikuar nga Huadhënësi(it) në kuadër të ekzekutimit të detyrueshëm të Barrës Siguruese mbi Kuotat dhe në vijim do të marrë autorizimin nga ERE brenda afatit përkatës të zbatueshëm për ERE-n, përveç rastit kur kjo periudhë zgjatet me ligj, me miratimin paraprak të Barrëmarrësit sipas gjykimit të tij të vetëm, dhe do t'i japë Barrëdhënësit kopje të dokumenteve që provojnë se është bërë aplikimi dhe një kopje të miratimit të ERE-s. Kjo Marrëveshje përbën autorizim dhe prokurë me shkrim nga Barrëdhënësi për Barrëmarrësin, me autorizimin e plotë të këtij të fundit për të aplikuar pranë ERE-s, për të marrë miratimin, etj., siç mund të kërkohet për ekzekutimin efektiv të Barrës Siguruese. Pavarësisht sa më sipër, nëse kërkohet specifikisht nga ligji, Barrëdhënësi i jep Barrëmarrësit autorizim me shkrim ose Prokurë të Posaçme, ku e autorizon Barrëmarrësin të ndjekë dhe të kryejë procedurën e mësipërme pranë ERE-s në Rastin e Ekzekutimit të Detyrueshëm.

**5.1.2** Barrëdhënësi jep miratimin përmes kësaj Marrëveshje dhe pa rezerva, për ekzekutimin e Barrës Siguruese të parashikuar në këtë Marrëveshje dhe për zbatimin e dispozitave



A2023030250102332330

part thereof) in the event of enforcement of the Securing Charge and the Chargor hereby consents the release, to the fullest extent permitted by law, any pre-emption right or any right of revocation or any other right that would impede the enforcement of this and with respect to the Collateral. In the case that the Chargee should seek to enforce the Securing Charge pursuant to this Clause 5.1, the Chargor shall, at its own expense, render forthwith all assistance necessary to facilitate the prompt enforcement of the Securing Charge. Notwithstanding the above, if the Parties will agree in writing that the sale will be made by the Chargor, the Chargee will provide the written consent in advance prior to the execution of the sale by the Chargor.

përkatëse të Legjislacionit Shqiptar, si dhe për shitjen dhe transferimin e Kolateralit (ose të çdo pjese të tij) në rast ekzekutimi të detyrueshëm të Barrës Siguruese dhe Barrëdhënësi përmes kësaj Marrëveshje heq dorë, në masën maksimale të lejuar me ligj, nga e drejta e parablertjes, ose çdo e drejtë revokimi ose nga çdo e drejtë tjetër që do të pengonte ekzekutimin e këtij dhe në lidhje me këtë Kolateral. Në rast se Barrëmarrësi do të kërkojë të ekzekutojë Barrën Siguruese në zbatim të këtij neni 5.1, atëherë Barrëdhënësi do të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme, me shpenzimet e tij, për të lehtësuar ekzekutimin e menjëhershëm të Barrës Siguruese. Pavarësisht sa më sipër, nëse Palët do të bien dakord me shkrim se shitja do të kryhet nga vetë Barrëdhënësi, atëherë Barrëmarrësi do të japë miratimin paraprak me shkrim përpara ekzekutimit të shitjes nga Barrëdhënësi.

**5.1.3** Any amount of all costs and expenses (including legal fees) reasonably incurred by the Chargee in connection with the enforcement of the Securing Charge or the preservation of any rights under this Agreement, shall be indemnified by the Chargor and the latter shall hold the Chargee harmless in respect of such costs and expenses. The Chargee's claim(s) to be indemnified in respect of the costs and expenses associating the enforcement shall be part of the Secured Obligations and their compensation will be received through and as part of the enforcement of this Agreement.

**5.1.3** Vlera e të gjitha kostove dhe shpenzimeve (përfshirë tarifat ligjore) të kryera në mënyrë të arsyeshme nga Barrëmarrësi në lidhje me ekzekutimin e Barrës Siguruese ose ruajtjen e të drejtave sipas kësaj Marrëveshje do të rimbursohet nga Barrëdhënësi dhe ky i fundit do ta mbajë Barrëmarrësin të dëmshpërblyer në lidhje me këto kosto dhe shpenzime. Kërkesa(at) e Barrëmarrësit për kompensim në lidhje me këto kosto dhe shpenzime lidhur me ekzekutimin, do të jetë pjesë e Detyrimeve të Siguruara dhe kompensimi i tyre do të merret përmes dhe si pjesë e ekzekutimit të kësaj Marrëveshje.

## 6 APPLICATION OF PROCEEDS

The proceeds of enforcement of the Securing Charge shall be paid to the Chargee for application in accordance

## 6 PËRDORIMI I TË ARDHURAVE

Të ardhurat nga ekzekutimi i Barrës Siguruese do t'i paguhen Barrëmarrësit për t'u përdorur në përputhje me



A2023030250102282330

with the provisions of the CTA and Clause 5.7(b) (Application of Proceeds of an Enforcement Action) of the Intercreditor Deed.

dispozitat e CTA dhe nenin 5.7(b) (Përdorimi i të ardhurave nga ekzekutimi i detyrueshëm) të Marrëveshjes mes Kreditorëve.

## 7 TERMINATION

Unless the Parties hereto agree in writing on an earlier termination, or unless this Agreement provides otherwise, the rights of the Chargee hereunder shall terminate on the date when the Chargee, based on the relevant written documentation, determines at its sole and absolute discretion that all of the Secured Obligations have been fully, irrevocably and unconditionally discharged / repaid to the Lenders, including the Chargee, and the Chargee is not under any commitment, obligation or liability (whether actual or contingent) to make advances or provide other financial accommodation to any of the Obligors under or pursuant to CTA (the "Release Date").

Upon termination of the Security Period, the Chargor shall execute and deliver to the Chargee such original or duly notarised copies of documents and compensate the Chargee accordingly for any related costs of expenses, as the Chargee shall reasonably request to evidence such termination, and at the form as requested by the Chargee.

## 7 PËRFUNDIMI

Përveçse kur Palët bien dakord me shkrim për zgjidhjen e parakohshme, ose përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, të drejtat e Barrëmarrësit sipas kësaj Marrëveshje shuhen në datën kur Barrëmarrësi përcakton, sipas diskrecionit të tij të vetëm dhe absolut, në bazë të dokumentacionit përkatës me shkrim, se të gjitha Detyrimet e Siguruara janë përmbushur / shlyer plotësisht dhe në mënyrë të pakthyeshme e të pakushtëzuar ndaj Huadhënësve, përfshirë Barrëmarrësin, dhe Barrëmarrësi nuk ka asnjë detyrim apo përgjegjësi (qoftë aktuale ose të mundshme) për të kryer paradhënie ose për t'i ofruar hua të tjera financiare ndonjërit prej Dorëzanësve sipas ose në përputhje me CTA ("Data e Çlirimit").

Pas përfundimit të Periudhës së Kolateralit, Barrëdhënësi do të nënshkruajë dhe do t'i dorëzojë Barrëmarrësit kopjet origjinale ose të noterizuara të dokumenteve, dhe do të kompensojë Barrëmarrësin përkatësisht për të gjitha kostot dhe shpenzimet përkatëse, për të gjitha dokumentet që Barrëmarrësi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme si dëshmi për këtë përfundim, si dhe në formën që kërkohet nga Barrëmarrësi.

## 8 REPRESENTATIONS AND WARRANTIES

### 8.1 Representations and Warranties of the Chargor

Without prejudice to the representations and warranties set forth in the CTA, the Chargor represents and warrants, and shall represent and warrants throughout the duration of the Security Period, to the Chargee as follows:

## 8. DEKLARATA DHE GARANCI

### 8.1 Deklaratat dhe Garancitë e Barrëdhënësit

Pa rënë në kundërshtim me deklaratat dhe garancitë e dhëna në CTA, Barrëdhënësi i deklaron dhe garanton Barrëmarrësit, si dhe do të vazhdojë t'i deklarojë dhe garantojë Barrëmarrësit gjatë gjithë kohëzgjatjes së Periudhës së Kolateralit, sa më poshtë:



A202305023010232330

- |  |  |
|--|--|
| <p>(a) The Chargor is the sole legitimate holder of the Shares.</p> <p>(b) there exists no Lien over the present and any future Shares in favour of third parties, except for the Securing Charge and the other Security Interests created under the Security Documents (as defined in the CTA);</p> <p>(c) the Chargor has full power and authority to create a valid, effective and enforceable first ranking Securing Charge over the Shares in favour of the Chargee;</p> <p>(d) no claims or proceedings are pending or to the best of its knowledge threatened before any court or arbitration panel, in the Republic of Albania or abroad, in connection with the present and any future Shares;</p> <p>(e) the Chargor is a company duly incorporated and in good standing under the laws of the Netherlands, it is not insolvent or undergoing any procedures of winding up, liquidation, bankruptcy or similar procedures, and no bankruptcy petition is submitted to any bankruptcy court, in the Republic of Albania or any other jurisdiction, and it has and will at all times have the necessary power to enter into and perform its obligations under this Agreement.</p> <p>(f) the first ranking Securing Charge:</p> <p>(i) has been validly granted and created by the Chargor and all the obligations hereunder constitute valid and binding and enforceable obligations of the Chargor and are in compliance with Albanian law;</p> <p>and</p> | <p>(a) Barrëdhënësi është pronari i vetëm legjitim i Kuotave.</p> <p>(b) Çdo Kuotë e tashme dhe e ardhshme, janë të parënduara me Barrë në favor të të tretëve, përveç Barrës Siguruese dhe Mjeteve të Sigurimit të Detyrimeve të tjera të krijuara sipas Dokumenteve të Kolateralit (të përcaktuara në CTA);</p> <p>(c) Barrëdhënësi ka tagrin dhe autoritetin e plotë për të krijuar Barrë Siguruese të radhës së parë mbi Kuotat, të vlefshme dhe të ekzekutueshme në favor të Barrëmarrësit;</p> <p>(d) nuk ka pretendime apo procedura gjyqësore që janë në proces apo që mund të nisnin, në dijeninë e tij, përpara ndonjë gjykate apo paneli arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, lidhur me Kuotat e tashme dhe të ardhshme;</p> <p>(e) Barrëdhënësi është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar rregullisht dhe që ushtron veprimtarinë e saj sipas legjislacionit të Holandës, nuk është në paaftësi paguese ose subjekt i asnjë procedure falimentimi, paaftësie paguese apo procedure të ngjashme, dhe nuk është bërë asnjë kërkesë për falimentim në asnjë gjykatë falimentimi në Republikën e Shqipërisë apo në ndonjë juridiksion tjetër, dhe ka e do të ketë në çdo kohë tagrin e nevojshëm për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet sipas saj;</p> <p>(f) Barra Siguruese e radhës së parë:</p> <p>(i) është dhënë dhe krijuar në mënyrë të vlefshme nga Barrëdhënësi dhe të gjitha detyrimet që burojnë nga kjo Marrëveshje përbëjnë detyrime të vlefshme dhe me fuqi detyruese dhe të ekzekutueshme për Barrëdhënësin dhe janë në përputhje me Legjislacionin Shqiptar; dhe</p> |
|--|--|



A2003050250102302330

- (ii) the granting, creation and perfection of the Securing Charge and the provisions contained in this Agreement do not violate and are not in conflict with any other agreement or undertaking to which the Chargor is party or any provision of law, decision, decree or other order of any court or public authority, corporate document or any of the constitutional documents of the Chargor;
- (g) save for the Security Interest created under this Agreement and the other Security Interests created under the Security Documents, the Chargor shall ensure to have full and unencumbered legal title to present and any future Shares free and clear from any Securing Charge or other Security Interest, Lien or any other right of third parties, and shall not be subject to any attachment, seizure, lien or other rights of third parties;
- (h) the Security Interests over the present and any future Shares and the provisions contained in this Agreement are not in conflict with any other agreement or undertaking to which the Chargor is a party or any provision of Law or corporate document binding on the Chargor;
- (i) Further, the Chargor represents and warrant to and undertake with the Chargee that the foregoing representations and warranties will be true and accurate throughout the continuance of this Agreement with reference to the facts and circumstances subsisting from time to time.

## 9 COVENANTS OF THE CHARGOR

### 9.1 Covenants of the Chargor

Without prejudice to the covenants set forth in the CTA, the Chargor covenant that, for so long as any Secured Obligations remain outstanding and until the Chargor

- (ii) dhënia, krijimi dhe kompletimi i Barrës Siguruese dhe dispozitat e parashikuara në këtë Marrëveshje nuk shkelin dhe nuk bien ndesh me asnjë marrëveshje apo veprim tjetër ku Barrëdhënësi është palë apo me asnjë dispozitë ligjore, vendime, dekrete apo vendime gjyqësore ose vendime të autoriteteve publike ose me asnjë dokument themelues të Barrëdhënësit;
- (g) përveç Interesit të Siguruar të krijuar sipas kësaj Marrëveshje dhe Mjet Sigurimi Detyrimi të tjera të krijuara sipas Dokumenteve të Kolateralit, Barrëdhënësi sigurohet të ketë titull të plotë ligjor dhe të pabarrësuar mbi Kuotat e tashme dhe të ardhshme, të parënduar nga asnjë Barrë Siguruese ose mjet sigurimi detyrimi tjetër, Barrë ose të drejta të tjera të të tretëve, dhe që nuk është objekt i ndonje barre bashkëngjitur nje mjeti sigurimi detyrimi, sekuestrimi, barre, hipotekimi ose të drejtash të tjera të të tretëve;
- (h) Interesi i Siguruar mbi Kuotat e tashme dhe të ardhshme, dhe dispozitat e parashikuara në këtë Marrëveshje nuk bien ndesh me asnjë marrëveshje apo kontratë tjetër në të cilën Barrëdhënësi është palë ose me dispozita të Ligjit apo dokumentacionit të brendshëm të shoqërisë me fuqi detyruese mbi Barrëdhënësin;
- (i) Barrëdhënësi më tej deklaron dhe garanton dhe i zotohet Barrëmarrësit se deklaratat dhe garancitë e mësipërme do të vazhdojnë të jenë të vërteta dhe të sakta përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje bazuar në faktet dhe rrethanat ekzistuese në çdo kohë.

## 9 PREMTIMET E BARRËDHËNËSIT

### 9.1 Premtimet e Barrëdhënësit

Pa rënë në kundërshtim me premtimet e dhëna në CTA, Barrëdhënësi premtion se, për sa kohë që Detyrimet e



A2003050250102233330

receives the confirmation in writing by the Chargee, issued upon request of the Chargor, that the Security Period has ended the Chargor at its own expenses shall:

- (a) not take any action:
  - (i) which may prejudice, directly or indirectly, the validity, effectiveness or enforceability of this Securing Charge and/or the rights and interests of the Chargee under the CTA or any other Finance Document; or
  - (ii) which may prejudice the existence, validity, effectiveness or enforceability of the CTA (including but not limited to this Agreement) or any other Finance Document or the rights of the Chargee under the CTA or any other Finance Document;
- (b) take, at its own expense, all actions which may be necessary or reasonably advisable to protect the validity, effectiveness and enforceability of the Securing Charge or the rights of the Chargee, including against claims made by third parties;
- (c) at its own expense, promptly execute and deliver all documents and take all actions which may be necessary or advisable in order to:
  - (i) when requested by the Chargee, register, complete and maintain the Securing Charge in full force and effect; and
  - (ii) enable any of the Chargee, as creditor and/or as creditor of the secured obligations, to exercise and enforce the rights and remedies to which it is entitled pursuant to this Agreement, including, without limitation, all rights and remedies exercisable upon the occurrence of an Enforcement Event;

Siguruara do të mbeten të papërbushura dhe deri sa Barrëdhënësi të marrë konfirmimin me shkrim nga Barrëmarrësi, të dhënë me kërkesë të Barrëdhënësit, se Periudha e Kolateralit ka përfunduar, Barrëdhënësi me shpenzimet e veta:

- (a) nuk do të ndërmarrë asnjë veprim:
  - (i) që mund të cënojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, vlefshmërinë, efektivitetin ose zbatueshmërinë e Barrës Siguruese dhe/ose të drejtave dhe interesave të Barrëmarrësit sipas CTA-së ose ndonjë Dokumenti tjetër Financimi; ose
  - (ii) që mund të cënojë ekzistencën, vlefshmërinë, efektivitetin ose ekzekutimin e CTA-së ose të ndonjë Dokumenti tjetër Financimi (përfshirë këtë Marrëveshje, por jo vetëm) ose të drejtat e Barrëmarrësit sipas CTA-së ose sipas ndonjë Dokumenti tjetër Financimi;
- (b) do të ndërmarrë, të gjitha veprimet që mund të jenë të nevojshme ose të këshillueshme, në mënyrë të arsyeshme, për të mbrojtur vlefshmërinë, efektivitetin dhe ekzekutimin e Barrës Siguruese ose të drejtave të Barrëmarrësit, edhe kundër pretendimeve të ngritura nga të tretë;
- (c) do të ekzekutojë dhe dorëzojë menjëherë të gjitha dokumentet dhe do të kryejë të gjitha veprimet që mund të jenë të nevojshme ose të këshillueshme me qëllim që:
  - (i) kur i kërkohet nga Barrëmarrësi, të regjistrojë, kompletojë dhe mbajë Barrën Siguruese në fuqi dhe efekt të plotë; dhe
  - (ii) të lejojë Barrëmarrësin si kreditor dhe/ose si kreditor të detyrimeve të siguruara, të ushtrojë të drejtat dhe mjetet ligjore që ai gëzon në zbatim të kësaj Marrëveshje, duke përfshirë, pa kufizim, të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore të zbatueshme nëse ndodh Rasti i Ekzekutimit të Detyrueshëm.



A202305025010230330

<p>(d) not change its form, unless with the consent in writing of the Chargee;</p> <p>(e) keep adequate corporate records and enable the Chargee to have access to and make copies or abstracts of such records;</p> <p>(f) not create or permit the creation, over all or part of any Collateral, of any Lien, securing interest, or other charge or encumbrance or the existence of any right of any third party whether ranking <i>pari passu</i> with or subordinate to the Securing Charge contained in this Agreement, except for the Securing Charge and the Security Interests created or expressly permitted to be created under this Agreement and the CTA;</p> <p>(g) not transfer or assign or otherwise dispose any of the rights under, and interests, entirely or partially, in the Securing Charge;</p> <p>(h) indemnify the Chargee for the material damages caused due to the gross negligence or wilful misconduct of the Chargor, and hold it harmless from any and all claims, charges and lawsuits raised and/or submitted by third parties, which are related to the Securing Charge;</p> <p>(i) keep the Shares insured as it is customary and reasonable for assets of similar type and nature, or as it is required by the Chargee and in conformity with the terms and conditions of the CTA and other Finance Documents;</p> <p>(j) promptly deliver to the Chargee all material notices and other documents and all information received in connection with all present and any future Shares, detailed to the extent required by the applicable legislation, and take, all actions which may be necessary or advisable to protect the validity, effectiveness and enforceability of this Agreement or the rights of the Chargee, also against claims made by third parties;</p>	<p>(d) nuk e ndryshon formën e tij ligjore, përveçse me miratimin me shkrim të Barrëmarrësit;</p> <p>(e) mban regjistra të saktë të shoqërisë dhe i mundëson Barrëmarrësit t'i shohë dhe të bëjë kopje ose të nxjerrë ekstrakte të këtyre regjistrave;</p> <p>(f) nuk krijon ose nuk lejon krijimin, mbi të gjithin ose një pjesë të Kolateralit, të asnjë Barre, garancie, barre siguruese tjetër, pengu ose ekzistencën e asnjë të drejte të asnjë pale të tretë, qoftë të renditur në të njëjtën radhë por proporcionalisht (<i>pari passu</i>) ose të nënrenditur ndaj Barrës Siguruese të parashikuar në këtë Marrëveshje, përveç Barrës Siguruese dhe Interesat e Suguruara të krijuar ose të lejuar shprehimisht për t'u krijuar sipas kësaj Marrëveshje ose CTA-s;</p> <p>(g) nuk transferon, tjetëron ose disponon në çdo mënyrë tjetër të drejtat dhe interesat, tërësisht apo pjesërisht, që burojnë nga Barra Siguruese;</p> <p>(h) kompenson Barrëmarrësin për dëmet e shkaktuara nga pakujdesia e rëndë ose shkelja me dashje e Barrëdhënësit, dhe e ruan atë të padëmtuar nga të gjitha pretendimet, akuzat dhe paditë e ngritura dhe/ose të paraqitura nga të tretë, të cilat lidhen me Barrën Siguruese;</p> <p>(i) i mban Kuotat të mbuluara me sigurimin që është i zakonshëm dhe i arsyeshëm për pasuri të llojit dhe natyrës së ngjashme me to, ose siç kërkohet nga Barrëmarrësi dhe në përputhje me kushtet e CTA-së dhe të Dokumenteve të tjera të Financimit;</p> <p>(j) i dërgon menjëherë Barrëmarrësit të gjitha njoftimet dhe dokumentet e tjera dhe të gjitha informacionet e rëndësishme të marra në lidhje me të gjitha Kuotat e tashme dhe të ardhshme, të detajuara në masën e kërkuar nga legjislacioni i zbatueshëm, dhe ndërmerr të gjitha veprimet që mund të jenë të nevojshme ose të këshillueshme</p>
---	--





A2023050250100232350

- (k) execute, acknowledge and deliver such further assignments, transfers and documents as may be reasonably requested by the Chargee in order to give effect to this Agreement and pay all costs for searches, registrations and filings;
- (l) reimburse the Chargee for any costs or expenses, including legal fees, incurred by the Chargee in enforcing this Agreement;
- (m) promptly furnish to the Chargee all material information, detailed to the extent required by law, received in connection with all present and any future Shares, and concerning this Securing Charge including without limitation claims made by third parties;
- (n) be refrained from selling any of the Shares subject to this Agreement, except from the use of the Shares without selling during the ordinary course of business.

## 10 INDEMNITY, TAXES, COSTS AND EXPENSES

### 10.1 Liability of the Chargee

The Chargee shall not be liable, except in case of its own gross negligence or wilful misconduct, for damages caused to the Chargor when exercising or failing to exercise the rights, actions or remedies to which it is entitled under this Agreement.

- për të mbrojtur vlefshmërinë, efektivitetin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshje ose të drejtave të Barrëmarrësit, edhe kundër pretendimeve të ngritura nga të tretë;
- (k) nënshkruan, pranon dhe dorëzon çdo dokument të mëtejshëm kalimi, transferimi, dhe çdo dokument tjetër që mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Barrëmarrësi me qëllim zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshje, si dhe paguan të gjitha shpenzimet për aplikime, regjistrime dhe depozitime;
- (l) rimbursion Barrëmarrësin për të gjitha kostot ose shpenzimet, përfshirë tarifatat ligjore, të kryera nga Barrëmarrësi për ekzekutimin e kësaj Marrëveshje;
- (m) i jep menjëherë Barrëmarrësit të gjithë informacionin e rëndësishëm, të detajuar në masën e kërkuar nga ligji, që ka marrë në lidhje me të gjitha Kuotat e tashme dhe të ardhshme, si dhe në lidhje me këtë Barrë Siguruese duke përfshirë pa kufizim pretendimet e ngritura nga të tretë;
- (n) nuk shet asnjë nga Kuotat objekt i kësaj Marrëveshje, përveç përdorimit të Kuotave pa shitje gjatë ushtrimit të aktivitetit të zakonshëm.

## 10 DËMSHPËRBLIMI, TAKSAT/TATIMET, KOSTOT DHE SHPENZIMET

### 10.1 Përgjegjësitë e Barrëmarrësit

Barrëmarrësi nuk përgjigjet, përveçse në rast pakujdesie të rëndë ose mosveprim me dashje, për dëmet që i shkaktohen Barrëdhënësit gjatë ushtrimit ose mosushtrimit të të drejtave, veprimeve ose mjeteve ligjore që ai gëzon sipas kësaj Marrëveshje.



A2023050250102332330

## 10.2 Indemnification

The Chargor will, upon demand, reimburse the Chargee for any and all incurred taxes and stamp duties, costs, expenses and fees of whatever type or nature (including but not limited to legal and notary fees) incurred by the Chargee in connection with:

- (i) the creation, completion / perfection, preservation and/or enforcement of the Securing Charge; and
- (ii) any failure by the Chargor to comply with the obligations under or in connection with this Agreement.

## 11 NOTICES

### 11.1 Addresses

All notices under or in connection with this Agreement shall be given at the following addresses:

- (a) if to the Chargee:

**Attention:** Multinational Client Department

**Address:** Rr. "Ismail Qemali", Nr.27, Tirana, Albania.

- (b) if to the Chargor:

**Attention:** Tea Stevens

**Address:** Sint Nicolaasstraat 14, 1012NK  
Amsterdam, The Netherlands.

### 11.2 Change of Address

Any Party may communicate to the others by registered mail (in Albanian 'Lajmërim Marrje') a different address for all notices.

### 11.3 Form of Notices

All the daily notices or other communications under or in connection with this Agreement shall be given in writing and, unless otherwise stated or

## 10.2 Dëmshpërblimi

Barrëdhënësi, në bazë të kërkesës, do të rimbursojë Barrëmarrësin për të gjitha taksat/tatimet, taksën e pullës, kostot, shpenzimet dhe tarifat e çfarëdo lloji e natyre (përfshirë pa kufizim tarifat ligjore dhe noteriale) të kryera nga Barrëmarrësi në lidhje me:

- (i) krijimin, kompletimin / perfeksionin, ruajtjen dhe/ose ekzekutimin e Barrës Siguruese; dhe
- (ii) mospërbushjen nga Barrëdhënësi të detyrimeve të tij që bëjnë nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

## 11 Njoftimet

### 11.1 Adresat

Të gjitha njoftimet sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të bëhen në adresat e mëposhtme:

- (b) nëse i drejtohen Barrëmarrësit:

**Në vëmendje të:** Multinational Client Department

**Adresa:** Rr. "Ismail Qemali", Nr.27, Tiranë, Shqipëri.

- (b) nëse i drejtohen Barrëdhënësit:

**Në vëmendje të:** Tea Stevens

**Adresa:** Sint Nicolaasstraat 14, 1012NK  
Amsterdam, The Netherlands.

### 11.2 Ndryshimi i Adresës

Secila nga Palët mund t'i komunikojë Palës tjetër me postë me 'Lajmërim Marrje', një tjetër adresë për marrjen e të gjitha njoftimeve.

### 11.3 Forma e Njoftimeve

Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera të përditshme sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të jepen me shkrim dhe, nëse



A2023050250102332330

required by the Law, will be made by email. All the formal communications under or in connection to this Agreement shall be in writing and, unless otherwise stated or required by the Law, will be made by certified/registered mail (in Albanian 'Lajmërim Marrje'). Any such notice shall be deemed to be given when the email or the mail, as applicable, is received by the addressee, provided that a notice received on a non-Business Day is deemed to be given on the next Business Day. However, any notice of an Enforcement Event shall in addition be given by certified/registered mail (in Albanian 'Lajmërim Marrje') and become effective upon delivery.

nuk parashikohet apo kërkohet ndryshe nga Ligji, do të dërgohen me email. Të gjitha komunikimet zyrtare sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të mbahen me shkrim dhe, nëse nuk parashikohet apo kërkohet ndryshe nga Ligji, do të dërgohen me postë me 'Lajmërim Marrje'. Çdo njoftim i tillë do të konsiderohet se është dhënë nëse emaili ose posta, sipas rastit, është marrë nga marrësi, me kusht që një njoftim i dhënë në një ditë jo-pune të konsiderohet se është marrë në Ditën e Punës pasuese. Megjithatë, çdo njoftim i Rastit të Ekzekutimit të Detyrueshëm duhet të dërgohet edhe me postë me 'Lajmërim Marrje' dhe ka efekt pas dorëzimit.

#### 11.4 Language

All certificates, reports, notices and other documents and communications given or delivered pursuant to this Agreement shall be in the English Language.

#### 11.4 Gjuha

Të gjitha vërtetimet, raportet, njoftimet dhe dokumentet dhe komunikimet e tjera të dhëna ose të dorëzuara në përputhje me këtë Marrëveshje do të jenë në gjuhën angleze.

### 12 MISCELLANEOUS PROVISIONS

### 12 DISPOZITA TË NDRYSHME

#### 12.1 Amendments and Waivers

No amendment or waiver to the provisions of this Agreement and no consent or approval given by the Chargee shall be effective unless it is made with the written consent of the Chargor and the Chargee. The Chargee may grant extensions of time and other indulgences, compromise, settle, grant releases and discharge and otherwise deal with the Chargor and the Securing Charge over the present and any future Shares as the Chargee may think appropriate, without prejudice to the liability of the Chargor and the Chargor and of the rights and obligations of the Chargee under this Agreement and/or Albanian Law.

#### 12.1 Ndryshimet dhe Shmangie

Asnjë ndryshim apo shmangie nga dispozitat e kësaj Marrëveshje dhe asnjë pëlqim apo miratim i dhënë nga Barrëmarrësi nuk do të ketë fuqi ligjore nëse nuk është bërë me pëlqimin me shkrim të Barrëdhënësit dhe Barrëmarrësit. Barrëmarrësi mund të miratojë zgjatje të afateve kohore dhe lehtësira të tjera, kompromise, pajtime, falje dhe çlirim nga detyrimi ose të hyjë në marrëveshje me Barrëdhënësin lidhur me Barrën Siguruese mbi Kuotat e tashme dhe të ardhshme, siç mund ta gjykojë të përshtatshme Barrëmarrësi, pa rënë ndesh me përgjegjësinë e Barrëdhënësit dhe me të drejtat dhe detyrimet e Barrëmarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose sipas Legjislacionit Shqiptar.



A2023050230102232330

## 12.2 Modification, Assignment, Novation

This Agreement shall be binding on the Chargor and its successors, transferees and assigns also upon any modification, assignment or novation of the CTA or any other Finance Document (including this Agreement) and the Chargor expressly agrees, to the continuation of the Securing Charge in the event of novation of all or part of the Secured Obligations, and the Chargor undertakes to confirm in writing prior to any modification, assignment or novation of the CTA or any other Finance Document or the transfer or assignment of the Secured Obligations, their agreement to such continuation.

## 12.3 Continuous Interest

The Securing Charge created by this Agreement shall be binding and enforceable on the Chargor, its successors and assigns, and shall remain in full force and effect, and shall constitute and be a continuing security notwithstanding any partial payment or fulfilment of the Secured Obligations and shall not in any way be prejudiced or affected by, any other lien, indemnities or guarantees granted by the Chargor in favour of any other party or any judgement or order obtained by the Chargee in respect of any Secured Obligations.

## 12.4 Assignment

The Chargor shall not transfer or assign, entirely or partially, any of their rights under this Agreement without the prior written consent of the Chargee. The Chargee may transfer its rights under this Agreement to any other party subject to the terms and conditions of the CTA.

## 12.2 Ndryshimi, Kalimi, Ripërtëritja

Kjo Marrëveshje ka fuqi detyruese mbi Barrëdhënësin dhe pasardhësit, perfituesit e transferimit dhe kalimit e tij, edhe në rast të ndryshimit, kalimit ose ripërtëritjes së CTA-së ose të çdo Dokumenti tjetër Financimi (përfshirë këtë Marrëveshje) dhe Barrëdhënësi bie dakord shprehimisht për vazhdimësinë e Barrës Siguruese në rast ripërtëritjeje të plotë apo të pjesshme të Detyrimeve të Siguruara, dhe Barrëdhënësi merr përsipër të konfirmojë me shkrim miratimin e tij, para ndryshimit, kalimit apo ripërtëritjes së CTA-së ose të ndonjë Dokumenti tjetër Financimi ose para transferimin apo kalimit të Detyrimeve të Siguruara.

## 12.3 Mjeti i Sigurimit të Detyrimit i Vazhdueshëm

Barra Siguruese e krijuar nga kjo Marrëveshje ka fuqi detyruese dhe është e ekzekutueshme për Barrëdhënësin, pasardhësit dhe perfituesit e kalimit e tij, dhe do të mbetet në fuqi dhe efekt të plotë, dhe do të përbëjë dhe do të jetë një mjet sigurimi detyrimesh i vazhdueshëm pavarësisht nga çdo pagesë ose përmbushje e pjesshme e Detyrimeve të Siguruara dhe nuk do të cenohet apo ndikohet në asnjë mënyrë nga ndonjë barrë tjetër, dëmshpërblim ose garanci e dhënë nga Barrëdhënësi në favor të ndonjë pale tjetër ose nga ndonjë vendim ose urdhër gjykate i marrë nga Barrëmarrësi në lidhje me ndonjë Detyrim të Siguruar.

## 12.4 Transferimi

Barrëdhënësi nuk do të transferojë apo kalojë, tërësisht apo pjesërisht, të drejtat sipas kësaj Marrëveshjeje pa miratimin paraprak me shkrim të Barrëmarrësit. Barrëmarrësi gëzon të drejtën të transferojë të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje tek çdo palë tjetër, në zbatim të rregullave dhe kushteve të CTA-së.



A2023050230102332330

## 12.5 Remedies Cumulative

- a) The rights, powers and remedies of the Chargee under this Agreement are cumulative and are not, nor are they to be construed as, exclusive of any rights, powers or remedies provided by law or otherwise and may be exercised from time to time and as often as the Chargee deems expedient.
- b) No delay or omission on the part of the Chargee in exercising any right or remedy under this Agreement shall impair that right or remedy or operate as or be taken to be a waiver of it nor shall any single, partial or defective exercise of any such right or remedy preclude any other or further exercise under this Agreement of that or any other right or remedy.

## 12.6 Taxes and Expenses

All duties, taxes and other public charges including, but not limited to, any stamp duty, court registration fees and notary fees, expenses, disbursements and charges which shall have become due and payable in connection with the preparation, negotiation, conclusion, delivery, registration, filing, completion, execution, perfection, amendment, waiver, consent, discharge, release, preservation and enforcement of this Agreement and of the Charge shall be borne by the Chargor. If any such charges are incurred by the Chargee, the Chargor shall reimburse the Chargee for all such charges promptly after receiving from the Chargee a relevant request accompanied by any receipt or other document reasonably evidencing the payment thereof by the Chargee.

## 12.5 Rivendosja tërësore e të drejtave

- a) Të drejtat, kompetencat dhe mjetet ligjore të Barrëmarrësit sipas kësaj Marrëveshje janë kumulative dhe nuk janë, dhe as nuk duhet të interpretohen si përjashtuese të ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti ligjor të parashikuar nga ligji ose me mjete të tjera, dhe mund të ushtrohen herë pas here dhe ngjeshërisht sa e gjykon të arsyeshme Barrëmarrësi.
- b) Mosushtrimi apo vonesa në ushtrimin nga ana e Barrëmarrësit e ndonjë të drejte ose mjeti ligjor sipas kësaj Marrëveshje nuk do ta dëmtojë atë të drejtë ose mjet ligjor ose nuk do të jetë ose konsiderohet të jetë heqje dorë prej tyre, si dhe ushtrim i vetëm, i pjesshëm ose i mangët i ndonjë të drejte ose mjeti ligjor të tillë nuk pengon ushtrimin e mëtejshëm sipas kësaj Marrëveshje të asaj të drejte ose mjeti ligjor ose të të drejtave ose mjeteve ligjore të tjera.

## 12.6 Taksat/Tatimet dhe Shpenzimet

Të gjitha detyrimet, taksat/tatimet dhe detyrimet e tjera publike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, çdo taksë pulle, tarifrat e regjistrimit gjyqësor dhe tarifrat noteriale, shpenzimet, disbursimet dhe tarifrat që do të bëhen të pagueshme në lidhje me përgatitjen, negocimin, përfundimin, dorëzimin, regjistrimin, depozitimin, plotësimin, ekzekutimin, kompletimin, ndryshimin, heqjen dorë, pëlqimin, shuarjen, çlirimin, ruajtjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje dhe të Barrës Siguruese do të mbulohen nga Barrëdhënësi. Nëse ndonjë tarifë e tillë paguhet nga Barrëmarrësi, Barrëdhënësi do t'i rimburojë menjëherë Barrëmarrësit të gjitha këto tarifa, pasi të marrë nga Barrëmarrësi kërkesën përkatëse të shoqëruar nga mandatpagesat ose dokumente të tjera justifikuese që dëshmojnë pagesën e kryer nga Barrëmarrësi.



A2023050250102332330

### 12.7 Securing Charge Agreement

The Chargor acknowledges expressly herein that this Agreement constitute a "Securing Charge Agreement" for the purposes of Article 2 of the Securing Charge Law and an "executive title" for the purposes of the Albanian Law and shall be subject to enforcement pursuant to the provisions of Article 31 of the Securing Charge Law.

### 12.8 Separate Security Interest

The Parties hereby expressly acknowledge and confirm that the Securing Charge over all present and any future Shares hereunder shall constitute a security interest on behalf of the Chargee separate from, and unrelated to, any other security interest which has been or shall have been granted by the Chargor or any other Obligor to the Chargee to secure the discharge of the Chargor's obligations to the Chargee under the CTA. The Parties hereby agree that the Chargee may exercise its rights hereunder irrespective of its rights under any other security interest securing the discharge of its obligations under the CTA.

### 12.9 Severability

The provisions contained in each clause and paragraph of this Agreement shall be enforceable, regardless of other provisions of this Agreement that may become unenforceable, and its validity shall not be affected if any of the other provisions is invalid. If any of the provisions is void, but would be valid if some part of the provision were deleted, the provision in question shall apply with such modification as may be necessary to make it valid.

### 12.7 Marrëveshja Barre Siguruese

Barrëdhënësi në këtë Marrëveshje njih dhe pranon shprehimisht se kjo Marrëveshje konsiderohet "Marrëveshje Barre Siguruese" për qëllime të nenit 2 të Ligjit për Barrët Siguruese dhe është "titull ekzekutiv" për qëllime të Legjislacionit Shqiptar dhe është objekt ekzekutimi në zbatim të dispozitave të nenit 31 të Ligjit për Barrët Siguruese.

### 12.8 Interes i Siguruar i Veçuar

Palët në këtë Marrëveshje pranojnë dhe konfirmojnë shprehimisht se Barra Siguruese mbi të gjitha Kuotat e tashme dhe të ardhshme, e krijuar sipas kësaj Marrëveshje përbën mjet sigurimi ekzekutimi detyrimi në favor të Barrëmarrësit, të ndarë dhe pa lidhje me, çfarëdolloj mjet sigurimi detyrimesh tjetër që i është dhënë apo do t'i jepet Barrëmarrësit nga Barrëdhënësi ose Dorezanes të tjerë për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të Barrëdhënësit ndaj Barrëmarrësit sipas CTA-së. Palët bien dakord se Barrëmarrësi ka të drejtë të ushtrojë të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshje, pavarësisht nga të drejtat e tij që rrjedhin nga ndonjë mjet sigurimi ekzekutimi detyrimesh tjetër e dhënë për të siguruar shlyerjen e detyrimeve të Barrëdhënësit sipas CTA-së.

### 12.9 Pavlefshmëria e pjesshme

Dispozitat e secilit prej neneve dhe paragrafëve të kësaj Marrëveshje janë të zbatueshme pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshje që mund të bëhen të pazbatueshme, dhe vlefshmëria e tyre nuk cenohet nëse cilado nga dispozitat e tjera është e pavlefshme. Nëse ndonjë nga dispozitat është e pavlefshme, por do të ishte e vlefshme nëse disa pjesë të dispozitës do të fshiheshin, dispozita në fjalë do të zbatohet me atë modifikim që mund të jetë i nevojshëm për ta bërë atë të vlefshme.



A202305025010232330

### 12.10 Credit Registry

Pursuant to the article 127 of Law no. 9662, dated 18.12.2006 "On the Banks in the Republic of Albania", as amended, Regulation no. 72/2020 "On the functioning of the Credit Registry in the Bank of Albania, as well as the conditions and procedures on the acknowledgement, use, and revision of the data administered" approved by the Supervisory Council of Bank of Albania, by signing this Agreement, the Chargor: (i) declares and guarantees upon its free and full will that the information provided herein is true, accurate and complete, and (ii) understanding that the demographic and financial data stored in the Credit Registry of the Bank of Albania will be treated in conformity with the primary and secondary legislation applicable on the personal data protection, the banking and professional secrecy, considering also that the Chargee is a second-tier bank in Albania and the Credit Registry of Bank of Albania have taken all the necessary measures on the safe treatment of the data; and also authorizes "Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA that for the purposes including: 1. assessment of the loan application; and/or 2. credit risk assessment over the entire duration of the loan contractual agreement with "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA; and/or 3. creditworthiness' assessment of the related person to the Chargor, to be informed about the liabilities of the Chargor due to the Lenders, through authorized processing of the data/information kept in Credit Registry aiming to assess the value of the credit exposure in the banking system, guarantees and creditworthiness/ability of the Chargor to settle the financial liabilities.

The Chargor hereby gives its consent that the Chargee may use the name and identification and financial data of the Chargor in order to make the standard and mandatory reporting in the Credit Registry of Bank of Albania.

The Chargor hereby declares that it is duly informed about the right to request information on the Chargor's data during the period of their maintenance by the Chargee as well as to correct / review if they are inaccurate, incomplete understanding that any request

### 12.10 Regjistri i Kredive

Në zbatim të nenit 127 të Ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Rregullores Nr. 72/2020 të Bankës së Shqipërisë "Për funksionimin e regjistrit të kredive në Bankën e Shqipërisë", si dhe kushtet dhe procedurat për njohjen, përdorimin dhe rishikimin e të dhënave që administrohen në të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, Barrëdhënësi nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marreveshje: (i) deklaron dhe garanton me vullnetin e plotë dhe të lirë se informacioni i dhënë, është i vërtetë, i saktë dhe i plotë, si dhe (ii) kupton se të dhënat demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë, do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se Barrëmarrësi është bankë e nivelit të dytë në Shqipëri dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave; si dhe (iii) autorizon Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, që për qëllimet që përfshijnë: 1. Vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi; dhe/ose 2. Vlerësimin e rrezikut të kredisë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies të kredisë me Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA; dhe/ose 3. Vlerësimin e besueshmërisë si person i lidhur me Barrëdhënësin, të njihet me detyrimet e Barrëdhënësit ndaj Huadhënësve, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrit të Kredive, për të vlerësuar vlerën e ekspozimit kreditor në sistemin bankar, garancitë dhe besueshmërinë/aftësinë e Barrëdhënësit për të shlyer detyrimet financiare.

Barrëdhënësi jep pëlqimin që Barrëmarrësi mund të përdorë emrin dhe të dhënat identifikuese dhe financiare të Barrëdhënësit për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.



A2023050250102232330

regarding the above can be addressed to the Chargee by using the following details:

To the attention of: Underwriting and Credit Portfolio Management Department

Address: Rr. "Ismail Qemali" No.27, Tirana, Albania

Email:

[KorrigjimRegjistriKredive@intesianpaolobank.al](mailto:KorrigjimRegjistriKredive@intesianpaolobank.al)

Telephone: +355 4 227 60000

Official website: [www.intesianpaolobank.al](http://www.intesianpaolobank.al)

The Chargee shall notify the Chargor as specified in this Agreement. about any eventual change of contact addresses specified in this clause herein.

#### 12.11 Data Protection

The Chargor declares that it recognizes and acknowledges the relevant legal consequences regarding the processing of personal data, financial information and/or any other information regarding the quality of the Chargor.

According to the Law no. 9887, dated 10.03.2008 "On personal data protection", as amended, and Law no. 9662, dated 18.12.2006 "On the Banks in the Republic of Albania", as amended, the Chargor does hereby irrevocably authorize the Chargee to transfer and treat all its personal and financial data (herein referred to as the "Confidential Information") with and to its Parent Company "Intesa Sanpaolo" S.p.A and/or to the Lenders, if and whenever it requested by this Parent Company or the Lenders. The Chargor understanding that its personal and financial data will be treated in conformity with the primary and secondary legislation applicable on personal data protection, the banking and professional secrecy, considering also that the Chargee and its Parent Company have taken all the necessary measures on the safe

Barrëdhënësi deklaron se është informuar siç duhet për të drejtën për të kërkuar informacion mbi të dhënat e Barrëdhënësit gjatë periudhës së mbajtjes së tyre nga Barrëmarrësi, si dhe korrigjimin/rishikimin në raste kur ato janë të pasakta, të paplota duke kuptuar se çdo kërkesë për sa më sipër mund t'ia drejtojë Barrëmarrësit sipas detajeve të mëposhtme:

Në vëmendjen te: Departamentit të Analizës dhe Administrimit të Portofolit të Kredive,  
Adresa: Rr. "Ismail Qemali" Nr. 27, Tiranë, Shqipëri,  
E-mail:

[KorrigjimRegjistriKredive@intesianpaolobank.al](mailto:KorrigjimRegjistriKredive@intesianpaolobank.al),

Telefoni: +355 4 227 60000

Faqja e internetit: [www.intesianpaolobank.al](http://www.intesianpaolobank.al)

Barrëmarrësi do të njoftojë Barrëdhënësin sipas mënyrave të përcaktuara në këtë Marreveshje, për çdo ndryshim eventual të adresave të kontaktit të përcaktuara më lart.

#### 12.10 Mbrojtja e të Dhënave

Barrëdhënësi deklaron se njih pasojat përkatëse ligjore në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, informacionit financiar dhe/ose çdo informacioni tjetër në lidhje me cilësinë e Barrëdhënësit.

Sipas Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Barrëdhënësi në mënyrë të parevokueshme autorizon Barrëmarrësin të transferojë dhe të trajtojë të gjitha të dhënat personale dhe financiare të tij (më poshtë referuar si "Informacioni Konfidencial") me dhe tek Shoqëria Mëmë e saj "Intesa Sanpaolo" S.p.A dhe/ose te Huadhënësit, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqëria Mëmë ose Huadhënësit. Barrëdhënësi duke kuptuar se të dhënat e tij personale dhe financiare do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar dhe profesional, si dhe duke marrë në konsideratë gjithashtu se Barrëmarrësi dhe Shoqëria Mëmë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme





A202303025010233330

treatment of the Chargor's data, does hereby authorize the Chargee, that for the purposes including: 1. assessment of the Chargor's loan application; and/or 2. credit risk assessment over the entire duration of the loan contractual agreement with the Chargee; and/or 3. creditworthiness' assessment of the Chargor together with the third parties related to the Chargor; and/or 4. the consolidated supervision by the Parent Company, including but not limited to the consolidation purposes of the following positions: (a) regulatory capital, (b) capital adequacy, (c) risk exposure, (d) open foreign exchange positions, (e) investments in the capital or non-capital institutions; and/or 5. monitoring and management of the risks of the Chargee and Intesa Sanpaolo Banking Group, or upon the consolidation of positions provided in the Law no. 9662, dated 18.12.2006 "On the Banks in the Republic of Albania", as amended, to transfer and treat all the personal and financial data with and to its Parent Company, and/or the Lenders if and whenever requested by this Parent Company or the Lenders. In compliance with the above, the Chargor does hereby authorize "Intesa Sanpaolo" S.p.A to access, use, and treat all the personal and financial data held by the Chargee and/or received by the latter from the Credit Registry of Bank of Albania. It is hereby understood that all the Confidential Information will be protected from the misuse, damage, destruction, depreciation, loss and theft and that "Intesa Sanpaolo" S.p.A will not use the Confidential Information for any other purpose, except for the purposes set out above, and it shall not disclose, make available, publish, or spread to third parties. "Intesa Sanpaolo" S.p.A will ensure that only the responsible persons (including the subcontractors and affiliates), to whom the information is disclosed pursuant to the fulfillment of the purposes defined above, will access the Confidential Information. Confidential Information may be disclosed to the extent required by law to the court, prosecution office, and other competent bodies entitled to this right based on the applicable law and regulations, to an arbitrator, or any regulatory authority. The Chargee and its Parent

për trajtimin e sigurt të të dhënave të Barrëdhënësit, autorizon Barrëmarrësin, që për qëllimet që përfshijnë: 1. vlerësimin e aplikimit të Barrëdhënësit për kredi; dhe/ose 2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë të gjithë afatit të marrëveshjes kontraktore të kredisë me Barrëmarrësin; dhe/ose 3. vlerësimin e besueshmërisë së Barrëdhënësit, së bashku me palët e treta të lidhura me Barrëdhënësin; dhe/ose 4. mbikëqyrjen e konsoliduar nga Shoqëria Mëmë, duke përfshirë por pa u kufizuar tek qëllimet e konsolidimit të pozicioneve të mëposhtme: (a) kapitalin rregulator, (b) mjaftueshmërinë e kapitalit, (c) ekspozimi i rrezikut, (d) pozicionet e hapura të këmbimeve valutore, (e) investimet në institucionet kapitale dhe jo kapitale; dhe/ose 5. monitorimin dhe procesin e administrimit të rreziqeve të Barrëmarrësit dhe të Grupit Bankar Intesa Sanpaolo, ose me konsolidimin e pozicioneve që parashikohen në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, - për të transferuar dhe trajtuar të gjitha të dhënat personale dhe financiare me dhe tek Shoqëria Mëmë e saj dhe/ose te Huadhënësit, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqëria Mëmë ose Huadhënësit. Në përputhje me sa më sipër, Barrëdhënësi autorizon "Intesa Sanpaolo" S.p.A të ketë akses, të përdorë dhe të trajtojë të dhënat personale dhe financiare që Barrëmarrësi ka në zotërim dhe/ose që merr në zotërim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu pranohet se i gjithë Informacioni Konfidencial do të mbrohet përpara keqpërdorimit, dëmtimit, shkatërrimit, zhvlerësimit, humbjes dhe vjedhjes dhe "Intesa Sanpaolo" S.p.A nuk do të përdorë Informacionin Konfidencial për asnjë qëllim tjetër përveçse për qëllimet që përcaktohen më sipër, si dhe nuk do t'i zbulohen, vihen në dispozicion, publikohen ose përhapen palëve të treta. "Intesa Sanpaolo" S.p.A do të sigurojë që vetëm personat përgjegjës (duke përfshirë nën-kontraktorët dhe filialet) të cilëve u zbulohet informacioni në funksion të përmbushjes së qëllimeve të parashikuara më sipër, do të kenë akses në Informacionin Konfidencial.



A30033050250102230330

Company will ensure the compliance by its personnel (including subcontractors and affiliates) with the confidentiality obligations undertaken.

The Chargor, in compliance with Law no.9887, dated 10.3.2008 "On Protection of Personal Data", as amended, (including but not limited to article 6 point 1 letter "a", article 8, and all the other legal and sub-legal provisions) and Law no. 9662 "On Banks in the Republic of Albania", as amended, grants its consent and hereby authorizes the Chargee to process, transfer and treats its personal data and financial information with and to any third party, which performs one or several services in the name and on behalf of the Chargee (including their subcontractors), located both inside and outside the territory of the Republic of Albania, contracted by the Chargee at its discretion for the purposes of exercising, monitoring, evaluating and continuously improving its banking and financial activity; however, expressly providing herein that third parties (including their subcontractors) will also be liable and have the obligation to maintain the confidentiality of personal and financial data to the Chargor.

The Chargee guarantees to the Chargor that the data processing will be managed by the technical staff of the office responsible for the processing of personal data and will be done in accordance with the ways provided by Law no. 9887, dated 10.03.2008 "On the protection of personal data", as amended. The Chargor by means of a written request addressed to the Chargee has the right (i) to receive at any time confirmation for the processing or not of its personal data, information on the purpose of processing, for the categories of processed data and for recipients and categories of recipients to whom the personal data of the Chargor is disclosed; (ii) be informed about the content and source of personal data processed by the Chargee; (iii) request their correction or deletion when it becomes aware that the data about it are not regular, true, complete or have been processed and collected in violation of the provisions of Law no. 9887,

Informacioni konfidencial mund të zbulohet deri në masën e parashikuar me ligj gjykatës, zyrës së prokurorisë dhe organeve të tjera kompetente që gëzojnë këtë të drejtë në bazë të ligjit dhe rregulloreve të zbatueshme, një gjykatësi ose çdo autoriteti rregullator. Barrëmarrësi dhe Shoqëria Mëmë e tij do të sigurojnë respektimin nga ana e Personelit të tij (duke përfshirë nënkontraktorët dhe filialet) të detyrimeve të konfidencialitetit të marra përsipër.

Barrëdhënësi, në përputhje me Ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, (duke përfshirë pa kufizim, nenin 6, pika 1, germa "a", nenin 8, dhe të gjitha dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore) dhe Ligjin nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, jep pëlqimin e tij dhe përmes kësaj Marrëveshje autorizon Barrëmarrësin të përpunojë, transferojë dhe trajtojë të dhënat e tij personale dhe informacionin e tij financiar me dhe tek çdo palë e tretë që kryen një ose disa nga shërbimet në emër dhe për llogari të Barrëmarrësit (përfshirë nënkontraktorët e tyre), të vendosur si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të kontraktuar nga Barrëmarrësi sipas gjykimit të tij për qëllime të ushtrimit, monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të aktivitetit bankar dhe financiar; por, duke parashikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje se palët e treta (përfshirë nënkontraktorët e tyre) do të ngarkohen gjithashtu me detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave personale dhe financiare të Barrëdhënësit.

Barrëmarrësi i garanton Barrëdhënësit se përpunimi i të dhënave do të administrohet nga stafi teknik i zyrës, përgjegjës për përpunimin e të dhënave personale dhe do të kryhet në përputhje me mënyrat e parashikuara nga Ligji nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Barrëdhënësi, me kërkesë me shkrim drejtuar Barrëmarrësit, ka të drejtë (i) të marrë në çdo kohë konfirmim për përpunimin ose jo të të dhënave të tij personale, informacion mbi qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të

REKRE  
10000



A2023050250100232350

dated 10.03.2008 "On the Protection of Personal Data", as amended; (iv) oppose, at any time, based on the law, the processing of its related data. The Chargor is entitled to the right to appeal if it claims that its rights, freedoms and legitimate interests related to personal data have been violated and breached. In the case that the Chargor has filed a claim, the Chargee will not make changes to its personal data until the decision is issued. The Chargor who has incurred a damage as a result of the illegal processing of the personal data, has the right to claim compensation from the Chargee for the incurred damage.

përpunuar dhe për marrësit dhe kategoritë e marrësve të cilëve u jepen të dhënat personale të Barrëdhënësit; (ii) të informohet rreth përmbajtjes dhe burimit të të dhënave personale të përpunuara nga Barrëmarrësi; (iii) të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur merr dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në shkelje të dispozitave të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar; (iv) të kundërshtojë, në çdo kohë, në bazë të ligjit, përpunimin e të dhënave të tij. Barrëdhënësi ka të drejtën e ankimit nëse pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale. Në rast se Barrëdhënësi ka bërë ankim, Barrëmarrësi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Nëse Barrëdhënësit i është shkaktuar dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kompensim Barrëmarrësit për dëmin e shkaktuar.

**13 WAIVER OF IMMUNITY**

**13.1** The Chargor represents and warrants that this Agreement and the securing charge of the Shares by the Chargor are commercial rather than public or governmental acts and that the Chargor is not entitled to claim any immunity from legal proceedings with respect to itself or any of its assets on the grounds of sovereignty or otherwise under any law or in any jurisdiction where an action may be brought for the enforcement of any of the obligations arising under or relating to this Agreement. To the extent that the Chargor or any of its assets has or hereafter may acquire any right to immunity from set-off, legal proceedings, attachment prior to judgement, other attachment or execution of judgement on the grounds of sovereignty or otherwise, the Chargor hereby irrevocably waives such rights to immunity in

**13 HEQJA DORË NGA IMUNITETI**

**13.1** Barrëdhënësi deklaron dhe garanton se kjo Marrëveshje dhe barra siguruuese mbi Kuotat e vendosur nga Barrëdhënësi, përbëjnë veprime tregtare dhe jo publike apo shtetërore dhe se Barrëdhënësi nuk ka të drejtë të kërkojë imunitet nga proceset ligjore në lidhje me vet atë apo me pasuritë e tij për arsye sovranitetit ose për arsye të tjera sipas çdo ligji ose në çdo juridiksion ku mund të ngrihet padi për ekzekutimin e ndonjë prej detyrimeve që burojnë nga kjo Marrëveshje ose në lidhje me të. Në masën që Barrëdhënësi ose ndonjë nga pasuritë e tij ka ose në vijim mund të fitojë ndonjë të drejtë për imunitet nga kompensimi, procedurat ligjore, sekuestrimi para gjykimit, sekuestrim tjetër ose ekzekutimi i vendimit në bazë të sovranitetit ose ndryshe, Barrëdhënësi heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga këto të



A2023050250102132330

respect of its obligations arising under or relating to this Agreement.

## 14 GOVERNING LAW AND JURISDICTION

### 14.1 Governing Law

This Agreement is governed by and shall be construed in accordance with the Albanian Law.

### 14.2 Jurisdiction

(a) The Chargor irrevocably agrees that the competent courts of the Republic of Albania shall have jurisdiction to settle any dispute arising out of or in connection with this Securing Charge Agreement (including a dispute relating to the existence, validity or termination of this security document or any non-contractual obligation arising out of or in connection with this Agreement) and that, accordingly, any suit, action or proceeding arising out of or in connection with this Securing Charge Agreement shall be brought in the competent courts of the Republic of Albania.

(b) The language used in any proceedings initiated by the Chargor and all documents submitted in connection with the proceedings shall be in the Albanian language and prepared as provided in the Albanian Law.

### 14.3 Privileges and immunities of EBRD

Nothing in this Agreement shall be construed as a waiver, renunciation or other modification of any immunities, privileges or exemptions of EBRD accorded under the Agreement Establishing the

drejta për imunitet në lidhje me detyrimet e tij që burojnë nga ose që lidhen me këtë Marrëveshje.

## 14 Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni

### 14.1 Ligji i Zbatueshëm

Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

### 14.2 Juridiksioni

(a) Barrëdhënësi bie dakord në mënyrë të pakthyeshme se gjykatat kompetente të Republikës së Shqipërisë kanë juridiksionin për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje Barre Siguruese (duke përfshirë çdo mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e këtij dokumenti mjet sigurimi detyrimesh ose çdo detyrimi jashtëkontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje) dhe se, përkatësisht, çdo pretendim, padi ose procedim që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje Barre Siguruese do të paraqitet përpara gjykatave kompetente të Republikës së Shqipërisë.

(b) Gjuha e përdorur në proceset gjyqësore të hapura nga Barrëdhënësi dhe në të gjitha dokumentet e paraqitura në lidhje me procesin do të jetë gjuha shqipe dhe përgatitja e tyre do të bëhet siç parashikohet në Legjislacionin Shqiptar.

### 14.3 Privilegjet dhe imunitetet e BERZH

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk kuptohet si heqje dorë, mohim ose ndryshim i imuniteteve, privilegjeve ose përjashtimeve të BERZH të dhëna nga Marrëveshja e Themelimit të Bankës Evropiane



AB02303023010230330

European Bank for Reconstruction and Development, international convention or any applicable law.

#### 14.4 No waiver of IFC immunity

The parties acknowledge and agree that no provision of this Agreement in any way constitutes or implies a waiver, termination or modification by IFC of any privilege, immunity or exemption of IFC granted in the Articles of Agreement establishing IFC, international conventions or applicable law.

#### 15. LANGUAGE

This Agreement has been signed in English and Albanian version, the Albanian version being a translation of the English document. In the case of any disputes of interpretation between the Albanian and the English version, the Albanian version shall prevail.

I, the Notary Public, after reading this Agreement loudly to the Parties hereto, am convinced that the Parties find the Agreement in conformity with their free will compile this Agreement, in presence of the translator Ms. Daniela Demiri in 4 (four) copies in English and 4 (four) copies in Albanian language and I certify their signatures of the signing Parties in conformity with the Albanian Law.

për Rindërtim dhe Zhvillim, konventa ndërkombëtare ose ligji i zbatueshëm.

#### 14.4 Imuniteti i IFC

Palët pranojnë dhe bien dakord që asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje në asnjë mënyrë nuk përbën ose nënkupton heqje dorë, shuarje ose ndryshim nga IFC të çdo privilegji, imuniteti ose përjashtimi të IFC-së të dhënë në Nenet e Marrëveshjes për themelimin e IFC-së, konventat ndërkombëtare ose ligji i zbatueshëm.

#### 15. GJUHA

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në versionet anglisht dhe shqip, ku versioni shqip është përkthim i dokumentit në anglisht. Në rast mospërputhjeje ndërmjet versionit shqip dhe atij anglisht, do të mbizotërojë versioni në shqip.

Unë, Noteri Publik, pasi u lexova me zë të lartë Palëve këtë Marrëveshje, jam bindur se Palët e gjejnë Marrëveshjen në përputhje me vullnetin e tyre të lirë, e përgatis këtë Marrëveshje, në prani të përkthyeses Zj. Daniela Demiri në 4 (katër) kopje në anglisht dhe 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe vërtetoj nënshkrimet e Palëve nënshkruese në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.



A2023050250102330350

**The Chargor:**

**VMI-ALB-Karavasta BV**

Name: **Oltjon Dano**

Title: **Authorised Representative**

*Oltjon Dano*  
*[Signature]*

**Barrëdhënësi:**

**VMI-ALB-Karavasta BV**

Emri: **Oltjon Dano**

Pozicioni: **Përfaqësues i Autorizuar**

*Oltjon Dano*  
*[Signature]*

**The Chargee:**


**INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA**

Name: **Ermenita Harasani**

Name: **Ervis Muço**

Title: **Authorized Representative**

*Ermenita Harasani*  
*[Signature]*  
*Ervis Muço*  
*[Signature]*



**Barrëmarrësi:**

**INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA**

Emri: **Ermenita Harasani**

Emri: **Ervis Muço**

Pozicioni: **Përfaqësues i Autorizuar**

*Ermenita Harasani*  
*[Signature]*  
*Ervis Muço*  
*[Signature]*

**Translator:**

**Daniela Demiri**

*Daniela Demiri*  
*[Signature]*

**Përkthyes:**

**Daniela Demiri**

*Daniela Demiri*  
*[Signature]*

**NOTARY PUBLIC**

**Loriana Robo**

*Loriana Robo*  
*[Signature]*

**NOTER PUBLIK**

**Loriana Robo**

*Loriana Robo*  
*[Signature]*



A2023050250102232350

## SCHEDULE A

### LIST OF SHARES

1 (one) share representing 100% of the share capital of Karavasta Solar SHPK, a limited liability company duly organized and existing as per the laws of the Republic of Albania, registered with the Commercial Registry on 20.08.2020 with the unique identification number (NUIS no.) M02020001J, with its legal seat at Rr. "Bajram Curri", Ndërtesa European Trade Center ("ETC"), Kati 14, Njësia Administrative nr. 2, 1000, Tirana, Albania, such share with the value of 867.386.000,00 Albanian Lekë<sup>1</sup>

## SHTOJCA A

### LISTA E KUOTAVE

1 (një) kuotë që përbën 100% të kapitalit të Karavasta Solar SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar më 20.08.2020 me numër unik identifikimi (nr. NUIS) M02020001J, me seli në adresën Rr. "Bajram Curri", Ndërtesa European Trade Center ("ETC"), Kati 14, Njësia Administrative nr. 2, 1000, Tiranë, Shqipëri, kjo kuotë me vlerë 867.386.000,00 Lekë<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> As per Extract dated 22.09.2023 retrieved by Commercial Registry of Republic of Albania (QKB).

<sup>2</sup> Sipas Ekstraktit datë 22.09.2023 të marrë nga Regjistri Tregtar i Republikës së Shqipërisë (QKB)